



*Shkarkimi i
regjistrimeve
bibliografike nga
rrjeti COBISS.net*



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization

Regional Centre for
Library Information Systems and
Current Research Information Systems
Regionalni center za knjižnične
informatijske sisteme in informatijske
sisteme o raziskovalni dejavnosti



© IZUM, 2024

IZUM, COBISS, COMARC, COBIB, COLIB, CONOR, SICRIS, E-CRIS, COBISS3, mCOBISS, COBISS+, dCOBISS janë marka të regjistruara në pronësi të institucionit publik IZUM.

PËRMBAJTJA

1	Informacionet kryesore	1
2	Informacionet e përgjithshme rreth shkarkimit të regjistrimeve nga rrjeti COBISS.net	1
	Procedurat fillestare të shkarkimit	1
	Kërkimi në COBISS.net	2
	Gjuha dhe shkrimi i katalogimit	2
	Transliterimi apo transkriptimi	3
3	Regjistrimi pas shkarkimit – karakteristikat sipas fushave/nënfushave të veçanta	3
	Kodi për regjistrimin e modifikuar (100g)	3
	Kodi për transliterimin (100i)	3
	Blloku i shënimeve (3XX)	3
	Analiza e përmbajtjes (blloku 6XX)	3
	Të dhënat për përgjegjësinë (blloku 7XX)	4

1 Informacionet kryesore

Rrjeti COBISS.net¹ lidh sistemet kombëtare të informacionit COBISS nga shtete të ndryshme dhe sistemet e tyre të informacionit për veprimtarinë kërkimore. COBISS.SI, COBISS.SR, COBISS.CG, COBISS.BH, COBISS.MK, COBISS.BG, COBISS.RS, COBISS.AL dhe COBISS.KS janë emërtime për sistemet autonome bibliotekare të informacionit, të cilat janë ndërtuar në Slloveni, Serbi, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Bullgari, Republikën Serbe, Shqipëri dhe në Kosovë.

COBISS Cat mundëson shkarkimin e regjistrimeve bibliografike nga bazat e tjera të përbashkëta bibliografike në rrjetin COBISS.net.

Procedura e shkarkimit të regjistrimeve bibliografike nga rrjeti COBISS.net është përshkruar në manualin *Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat*. Për katalogimin në sistemet COBISS përdoren standardet e katalogimit, të cilat janë caktuar në nivel kombëtar, si dhe udhëzime të tjera kombëtare. Udhëzimet për shënimin e të dhënave brenda formatit janë përshkruar në manualin *Formati COMARC/B*, udhëzimet për përdorimin e programit në manualin *Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat* dhe në manualin *COBISS3/Katalogimi*, ndërsa mund të përdoret edhe materiali nga *Kursi i avancuar*².

2 Informacionet e përgjithshme rreth shkarkimit të regjistrimeve nga rrjeti COBISS.net

Procedurat fillestare të shkarkimit

Të gjitha lejet³ për katalogimin e përbashkët përfshijnë edhe autorizimet për shkarkimin e regjistrimeve nga rrjeti COBISS.net. Në COBISS Cat mund të shkarkohen regjistrime bibliografike për të gjitha llojet e materialeve. Kjo varet vetëm nga leja që posedoni, p.sh. për shkarkimin e regjistrimeve për materialet jolibra nevojitet leja C – autorizimi për katalogimin e përbashkët të materialeve jolibra.

Shkarkimi i regjistrimeve nga rrjeti COBISS.net nuk është i detyrueshëm. Nëse do ta shkarkoni apo do ta krijoni një regjistrim të ri, varet nga plotësia e regjistrimit në rrjetin COBISS.net. Nëse mendoni se përmirësimi apo plotësimi i regjistrimit do të marr shumë kohë, regjistrimin nuk e shkarkoni por atë e krijoni nga fillimi. Regjistrimi në rrjetin COBISS.net ju ndihmon edhe nëse atë vetëm e transferoni në hapësirën e punës dhe nga ai i kopjoni të dhënat.

Nëse në rrjetin COBISS.net ekzistojnë disa regjistrime për materialin e njëjtë, përzgjidhni atë që ju përshtatet më shumë.

Regjistrimi nga rrjeti COBISS.net në sistemin e caktuar mund të shkarkohet vetëm një herë. Nëse regjistrimin, i cili tashmë ndodhet në bazën tuaj lokale, dëshironi ta shkarkoni përsëri, programi verifikon ID-në e regjistrimit dhe ju njofton se kjo nuk është e mundur. Gjithashtu, nuk

¹ COBISS.Net. Qasja në <https://www.cobiss.net/al/> (10.11.2020).

² Përdorimi i programit COBISS/Katalogimi – kursi i avancuar.

³ Shih manualin COBISS3/Katalogimi, kap. 2.5.

mund ta shkarkoni regjistrimin i cili është i përzgjedhur për t'u fshirë (në nënfushën 001a është kodi "d" – regjistrim i fshirë).

Në fushën e sistemit të regjistrimit të shkarkuar shënohet data e shkarkimit të regjistrimit nga rrjeti COBISS.net dhe emri i personit që e ka shkarkuar regjistrimin. Te emri i personit që e ka krijuar regjistrimin shtohet shenja e bazës së përbashkët COBIB, nga e cila regjistrimi është shkarkuar. Regjistrimi merr versionin 1 dhe mban numrin identifikues të sistemit COBISS, nga i cili është shkarkuar: p.sh. 25. 12. 2008 UBBIT::JOLANDA1-COBIBMK Updated: 26. 11. 2015 IZUM::ANDREJA Copied: 0 COBISS.net: 24.11.2015 IZUM::ANDREJA⁴.

Regjistrimet e ngarkuara në hapësirën e punës kanë shenjën "COBISS.net + (emri i bazës së të dhënave) + COBISS.ID" (p.sh. COBISS.net (KS) 756503).

Regjistrimet në rrjetin COBISS.net

Regjistrimet bibliografike në rrjetin COBISS.net janë në formatin COMARC/B. Pas shkarkimit të regjistrimit nga COBISS.net maska e shënimit të të dhënave mbetet e njëjtë, siç e ka pasur regjistrimi origjinal. Të dhënat e caktuara përshtaten në mënyrë automatike me rregullat, të cilat vlejnë në sistemin, në të cilin është shkarkuar regjistrimi. Shprehjet që shfaqen shpesh në regjistrime (p.sh. përcaktimi i përgjithshëm i materialit), përkthehen, ndërsa ato me domethënie lokale fshihen (p.sh. kodi i kërkuesit shkencorë).

Para se të ruhet regjistrimi, të dhënat verifikohen dhe sipas nevojës plotësohen ose redaktohen në përputhje me rregullat e vlefshme të katalogimit.

Kërkimi në COBISS.net

Në dritaren për kërkim COBISS Cat përzgjidhni bazën e të dhënave COBISS.net⁵. Mund të kërkoni njëherësh në të gjitha bazat e të dhënave në rrjetin COBISS.net.

Gjuha dhe shkrimi i katalogimit

Në rrjetin COBISS.net në procesin e katalogimit përdoren gjuhë të ndryshme. Gjatë shkarkimit të regjistrimeve disa fraza përkthehen në mënyrë automatike në gjuhën e sistemit në të cilin shkarkohen, ndërsa të dhënat e tjera mbeten në gjuhën e sistemit COBISS, nga i cili shkarkohen regjistrimet. Këto të dhëna duhet të përkthehen në gjuhën e katalogimit në përputhje me rregullat e katalogimit. Duhet të keni kujdes të veçantë në shënimet e bllokut 3XX.

COBISS Cat mundëson shënimin e të dhënave në shkrim latin dhe cirilik. Në sistemet COBISS që përdorin shkrimin cirilik, në regjistrimet bibliografike dhe ato të njësuara përdoren të dy llojet e shkrimit, ndërsa në sistemet e tjera COBISS të dhënat vendosen vetëm në shkrim latin. Në sistemet COBISS që përdorin vetëm shkrimin latin, gjatë shkarkimit të regjistrimeve shkrimi cirilik në redaktues shndërrohet në mënyrë automatike në shkrim latin.

⁴ Gjatë shkarkimit të regjistrimit nga rrjeti COBISS.Net në bazën lokale të të dhënave indeksohen data e shkarkimit të regjistrimit. Regjistrimet e shkarkuara nga bazat e caktuara në rrjetin COBISS.Net, në bazën tuaj lokale ose në bazën e përbashkët i kërkoni me parashtesën CR=, pas të cilës vendoset një yll dhe emri i bazës së përbashkët, nga e cila është shkarkuar regjistrimi (p.sh. CR=*COBIBBH AND DM=20200203).

⁵ Shih Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat.

Transliterimi apo transkriptimi

Për vendosjen e të dhënave për burimet bibliografike, të shkruara me shkrim jolatin, në sistemet COBISS përdoren sisteme të ndryshme të transliterimit apo transkriptimit.

3 Regjistrimi pas shkarkimit – karakteristikat sipas fushave/nënfushave të veçanta

Kodi për regjistrimin e modifikuar (100g)

Nënfusha 100g plotësohet vetëm në rastet kur simbolet që ofron sistemi nuk mjaftojnë për përshkrimin e të dhënave nga njësia. Kodi "1" – *regjistrim i modifikuar*, vendoset kur transliterohen apo transkriptohen shkrimet e veçanta (p.sh. shkrimi grek) ose formulat e veçanta matematikore. Kodi "0" – *regjistrim i pamodifikuar* vendoset kur faqja e titullit nuk mund të transkriptohet, për shkak se përmban simbole ose fotografi, të cilat nuk gjenden në asnjë grup të simboleve.

Kodi për transliterimin (100i)

Kodi në nënfushën 100i tregon llojin e transliterimit të përdorur. Kodi "b" – *transliterime të tjera* përdoret për transliterimin sipas PPIAK, përfshirë edhe transliterimin për shkrim cirilik.

Blloku i shënimeve (3XX)

Pas shkarkimit të regjistrimit të dhënave në bllokun 3XX janë në gjuhën e sistemit COBISS, nga i cili është shkarkuar. Për shkak se shënimet bëhen në gjuhën e katalogimit (përveç citeve), ato pas shkarkimit të regjistrimit përkthehen, duke respektuar rregullat e vlefshme dhe duke përdorur frazat hyrëse e shkurtesat standarde. Gjithashtu duhet të shtohen të gjitha shënimet që mungojnë.

Analiza e përmbajtjes (blloku 6XX)

Gjatë shkarkimit të regjistrimeve në rrjetin COBISS.net transferohen edhe emërtimet lëndore. Këto të dhëna mund t'i fshini ose t'i ruani, varësisht nga nevojat e bibliotekës. Nëse në fushat për emërtimet lëndore nuk kanë qenë kodet për sistemin e emërtimeve lëndore, shtohet kodi përkatës i sistemit COBISS, nga i cili shkarkohet regjistrimi, p.sh. *BG – Listë e paspecifikuar e emërtimeve lëndore COBISS.BG*.

Redaktohen apo plotësohen edhe të dhënat në fushën 675 – *Klasifikimi Dhjetor Universal (KDU)*.

Të dhënat për përgjegjësinë (blloku 7XX)

Në sistemet kombëtare COBISS, në të cilat aplikohet kontrolli i njësuar vetëm për emrat vetjakë apo edhe për emrat e organizatave, fusha me kontroll të njësuar duhet të lidhet me regjistrimet e njësuara përkatëse përmes nënfushës 7XX3.